



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**RREGULLORE (QRK) - NR. 21/2024 PËR MENAXHIMIN E PROGRAMIT
PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR¹**

¹ Rregullore (QRK) - Nr.21/2024 për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar është miratuar në Mbledhjen e 216-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 06/216 të datës 14.08.2024;

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 19, paragrafi 1.1, të Ligjit Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, nenin 8, paragrafi 4, nën-paragrafi 4.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Miraton:

RREGULLORE (QRK) - NR. 21/2024 PËR MENAXHIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat e menaxhimit të burimeve financiare të programit, duke përfshirë edhe formulën e financimit, kriteret, vlerësimin, menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të projekteve që financohen nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, konform dokumenteve të Ministrisë përkatëse për Zhvillim Rajonal dhe dokumenteve planifikuese dhe buxhetore të Qeverisë dhe Ministrisë përgjegjëse për financa si dhe buxhetit të miratuar.

2. Kjo rregullore është në përputhshmëri me Rregulloret e BE-së 1299/2013, 1301/2013 dhe 1303/2013.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore është e zbatueshme për Ministrinë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal, institucionet e administratës shtetërore, Komunitat, Qendrat për Zhvillim Rajonal, organizatat joqeveritare, bizneset dhe partnerët.

Neni 3 Përkufizimet e termave dhe shkurtesave

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e përcaktuara me nenin 3 të Ligjit përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

Neni 4
Parimet e Zhvillimit Rajonal të Balancuar

Parimet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e përcaktuara me Ligjin përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

KAPITULLI II
PROGRAMI PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR

Neni 5
Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar

1. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (më tutje PZHRB) është dokument i programimit që përcakton masat, aktivitetet për arritjen e objektivave sipas prioriteteve për zhvillim rajonal të balancuar, burimet financiare dhe autoritetet përgjegjëse.
2. PZHRB përcakton drejtimet prioritare të zhvillimit rajonal të balancuar përmes projekteve afatshkurtra dhe afatmesme si dhe financimin e tyre në mënyrë që të krijojë zona socio-ekonomike të qëndrueshme në kuadër të rajonit zhvillimor duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara për zhvillim rajonal të balancuar.
3. PZHRB është mekanizëm për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve për zhvillim rajonal të përfshira në këtë program si dhe planit operacional për zhvillim rajonal të rajonit zhvillimor.
4. PZHRB përcakton kornizën e monitorimit të zbatimit të aktiviteteve, vlerësimin e arritjes së objektivave dhe monitorimin, vlerësimin dhe kontrollin e zbatimit të projekteve për zhvillim rajonal të balancuar.

Neni 6
Struktura dhe përmbajtja e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

1. PZHRB propozohet nga Ministria për një periudhë afatmesme trevjeçare dhe miratohet nga Qeveria.
2. PZHRB mund të rishikohet në baza vjetore gjatë procesit të planifikimit buxhetor për secilin vit fiskal. PZHRB i rishikuar miratohet nga Qeveria.
3. PZHRB bazohet në strukturën e dokumenteve të politikave publike të përcaktuar me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe udhëzuesit përkatës për këto dokumente.
4. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar përmban:

4.1 Përmbledhje e analizës së gjendjes aktuale në zhvillimin rajonal dhe nevojave për zhillim rajonal të balancuar;

4.2. Objektivat e përgjithshme, objektivat specifike, si dhe treguesit dhe caqet në dy nivele të objektivave.

4.3. Masat për nxitjen e zhvillimit rajonal.

4.4. Aktivitetet e zbatimit, afatet kohore, dhe përgjegjësit e zbatimit.

4.5. Buxhetin dhe burimet e financimit.

4.6. Mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të zbatimit të programit.

Neni 7

Përgatitja e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

1. Ministria përgjegjëse për zhvillimin rajonal koordinon procesin e hartimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

2. Përgatitja e PZHRB-së bëhet në pajtim me rregullat për përgatitjen e dokumenteve të politikave publike, respektivisht, rregullat për nismat e tyre, themelimin e mekanizmave për përgatitjen e tyre, procesin e konsultimit, shqyrtimit dhe procedimit për miratim në Qeveri të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe udhëzuesit përkatës.

3. PZHRB hartohet në pajtim me kornizën për planifikim strategjik të Qeverisë dhe shërben për zbatimin e dokumenteve të politikave publike gjegjësisht dokumentet strategjike në nivel të qeverisë dhe ministrisë përkatëse për zhvillim rajonal.

4. PZHRB përgatitet për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në dokumentet planifikuese ku përcaktohen prioritetet dhe programet e zhvillimit rajonal të balancuar të cilat i përgatit ministria përgjegjëse për zhvillim rajonal dhe i miraton Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 8

Fushat e financimit përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

1. Ndarja buxhetore përcaktohet me Ligjin për ndarjen e buxhetit të vitit përkatës fiskal, i cili buxhet ndahet në dy kategori ekonomike: atë të investimeve kapitale dhe subvencione dhe transfere.

2. Fushat e financimit përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar janë të përcaktuara me nenin 10, paragrafi 9, të Ligjit përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

3. PZHRB përfshinë për financim masat dhe projektet që adresojnë prioritetet dhe objektivat e identifikuara me Program dhe kanë ndikim në zhvillimin, avancimin dhe promovimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar në rajonet zhvillimore.

4. Ministria, bazuar në vlerësime paraprake, përmes udhëzuesit për thirrje publike për aplikim përcakton specifika të veçanta për financim.

Neni 9 **Përfituesit e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar**

1. Përfituesit e mundshëm të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, sipas Ligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe kësaj rregulloreje, janë:

1.1. Komunat si dhe institucionet tjera në nivel të komunës;

1.2. Qendrat për Zhvillim Rajonal;

1.3. Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore;

1.4. Organizatat e Shoqërisë Civile;

1.5. Bizneset;

2. Kushtet dhe kriteret e përgjithshme për aplikim përcaktohen me këtë rregullore, ndërsa kriteret specifike përcaktohen me PZHRB, si dhe me udhëzuesit për thirrjet publike për aplikim.

KAPTULLI III **KUSHTET DHE KRITERET E FINANCIMIT**

Neni 10 **Kushtet e përgjithshme të financimit nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar**

1. Projektet që kërkohen të financohen përmes PZHRB kanë për qëllim të arrijnë objektivat, prioritetet dhe masat e përcaktuara në dokumentet e politikave dhe planifikimeve për zhvillim rajonal të balancuar.

2. Përfituesit e mbështetjes financiare nga PZHRB duhet të disponojnë me kapacitete institucionale, duke përfshirë burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar projektet e përfshira në PZHRB.

3. Për të përfituar prej PZHRB-së secili rajon duhet t'i ketë të themeluara qendrat për zhvillim rajonal. Kushti për themelimin e qendrave për zhvillim rajonal do të hyj në fuqi 3 muaj pas miratimit të Rregullores përkatëse për themelimin e qendrave për zhvillim rajonal.

4. Për të përfituar prej PZHRB-së secili rajon duhet të ketë të miratuar planin operacional për zhvillimin e rajonit përkatës.

Neni 11

Kriteret për Komunat si dhe institucionet tjera në nivel të komunës

1. Komunat mund të aplikojnë për projektet në kuadër të masave të programit për mbështetje financiare për komunat dhe të cilat janë përfshirë në planin operacional të rajonit zhvillimor të cilit i përket.

2. Komuna duhet të propozojë projektin që është në pajtueshmëri me objektivin e përgjithshëm të PZHRB-së dhe objektivat dhe përparësitë të përcaktuara në planin operacional të cilit i përkasin.

3. Një projekt ideor dhe vlerësimi paraprak i kostos duhet të përgatitet nga komunat. Projekti ideor duhet të jetë në pajtueshmëri me normat ekzistuese dhe standardet e aplikueshme në Kosovë.

4. Nga projektet që aplikon komuna, duhet të dëshmohet se përfitojnë banorët e më shumë se një komune brenda rajonit të cilit i përket apo rajonit tjetër.

5. Projekti për të cilin aplikon komuna duhet të jetë projekt i ri dhe jo vazhdimësi e ndonjë projekti tjetër (Përrjashtimisht në rastet kur projekti bartet nga viti paraprak i financuar nga MZHR);

6. Komunat përfituese duhet të ofrojnë minimumin e bashkëfinancimit të projekteve siç përcaktohet me PZHRB dhe thirrjet publike për aplikim.

7. Komunat përfituese duhet të kenë të nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit ndër-komunal për themelimin e Qendrës për zhvillim rajonal në kuadër të rajonit të cilit i përkasin.

8. Komunat mund të aplikojnë vetëm për projektet të cilat sipas PZHRB-së i përkasin kategorisë së investimeve kapitale.

9. Bashkëfinancimi, vlerat dhe rregullat e detajuara për bashkëfinancimin e projekteve përcaktohen në harmoni me dokumentet planifikuese, marrëveshjen e bashkëfinancimit në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin përkatës.

Neni 12
Kriteret për Qendrat për Zhvillim Rajonal

1. Qendrat për Zhvillim Rajonal mund të aplikojnë për projekte të cilat zbatohen për të mundësuar dhe lehtësuar zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre.
2. Qendrat për Zhvillim Rajonal mund të aplikojnë për projekte të cilat janë në pajtim me objektivat dhe përparësitë e përcaktuara me planet operationale zhvillimore të cilave ju përkasin dhe të miratuara nga MZHR.
3. Projektet e propozuara duhet të përfshijnë kategoritë ekonomike të shpenzimeve të cilat janë të pranueshme sipas PZHRB dhe udhëzimeve të ofruara sipas thirrjeve të projekteve.

Neni 13
Kriteret për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore

1. Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore mund të aplikojnë në projekte të cilat janë të dedikuara për rajonin zhvillimor të cilit i përkasin.
2. Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore të cilat aplikojnë për projekte duhet të kenë të nënshkruara marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal.
3. Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore të cilat aplikojnë për projekte të cilat kanë si përfitues kryesor studentët e tyre.

Neni 14
Kriteret për bizneset

1. Bizneset mund të aplikojnë për projektet në kuadër të masave të programit për mbështetje financiare për biznese.
2. Të jetë në pronësi të shtetasit/ve të Republikës së Kosovës. Në rast se biznesi aplikues është shoqëri aksionare, njëri nga aksionarët të jetë shtetas i Kosovës.
3. Dëshmi se është biznes i regjistruar në ARBK dhe ka selinë në rajonin prej të cilit aplikojnë për të përfituar.
4. Të jetë ndërmarrje në pronësi 100% private e regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës;
5. Të jetë në gjendje të demonstrojë likuiditetin e kompanisë (apo likuiditetin potencial);

6. Të jetë i regjistruar për aktivitetet e parapara me veprimin e propozuar në kohën e aplikimit për grantin. Bizneset e reja duhet të jenë të regjistruara para nënshkrimit të kontratës për grantin për të cilin janë përzgjedhur.
7. Të jenë të licencuara nëse kërkohet licencë për veprimtarinë që zhvillojnë.
8. Të mund të demonstrojnë që të gjitha kontributet dhe tatimet janë përmbushur.
9. Të jenë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e veprimeve të tyre.
10. Të mos kenë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave, kanë hyrë në marrëveshje me kreditorë, kanë pezulluar aktivitetet afariste, i janë nënshtruar procedurave në lidhje me këto çështje, ose janë në situata analoge.
11. Nuk mund të përfitojnë ata, apo personat që kanë autorizim përfaqësimi, vendimmarrjeje apo kontrolli mbi ta, kanë qenë subjekt i një aktgjykimi të prerë e të plotfuqishëm për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizatë kriminale, shpërlarje të parave apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm, ku aktiviteti i tillë i paligjshëm është dëmtues për interesat financiare të Kosovës.
12. Nuk mund të jenë përfitues të më shumë se një projekti deri në fund të periudhës së monitorimit të tyre.

Neni 15

Kriteret për Organizatat e Shoqërisë Civile

1. Organizatat Jo-qeveritare mund të aplikojnë për projektet në kuadër të masave të programit për mbështetje financiare për OJQ-të.
2. Pjesëmarrja e Organizatave Jo-qeveritare në projektet për zhvillim rajonal të balancuar bëhet sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe sipas kriterëve të përcaktuara me Rregulloren mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Organizatat Jo-qeveritare mund të aplikojnë për projekte të rajonit në të cilin e kanë të shtrirë veprimtarinë e tyre.
4. Mos të ketë pranuar mjete financiare për të njëjtin aktivitet gjatë të njëjtit vit të aplikimit.

Neni 16

Kriteret specifike

1. Te rastet e marrëveshjeve mes Ministrisë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal dhe donatorëve për financim apo bashkëfinancim të projekteve që janë në përputhje me fushat, objektivat dhe kriteret minimale të PZHRB-së, procedura këto që mund të harmonizohen sipas marrëveshjeve mes

Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal dhe donatorit/ëve dhe partnerëve (Organizata dhe institucione të specializuara).

2. Kriteret specifike mund të caktohen me udhëzuesit për thirrjet publike për aplikim nga Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal.

Neni 17

Kufizimet në përzgjedhjen e projekteve për financim

1. Ministria përgjegjëse për Zhvillim Rajonal për secilën thirrje publike për aplikim, varësisht nga kategoria buxhetore dhe kategoria e përfituesit potencial, përcakton kufizimet në financim në rast kur ka:

1.1. konflikt interesi,

1.2. kontestet pronësore,

1.3. financim të dyfishtë,

1.4. obligimet financiare,

1.5. aktgjykimi të formës së prerë (për vepër penale),

1.6. kufizime tjera të përcaktuara në udhëzuesin për thirrjen për aplikim.

2. Ministria përgatit dhe mirëmban bazën e shënimeve me të dhëna vjetore të projekteve nga fushat sektoriale, në të cilën duhet të bazohet për të faktuar kufizimet e vendosura si më lart.

Neni 18

Planifikimi financiar

1. Burimet e financimit të zhvillimit rajonal të balancuar në Republikën e Kosovës janë:

1.1. Buxheti i Republikës së Kosovës;

1.2. Vendet e Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë.

2. Procesi i planifikimit të burimeve të financimit bëhet në përputhje të plotë me ciklin e planifikimit buxhetor vjetor sipas afateve kohore që i përcakton Ministria përkatëse e financave.

3. Ministria përgjegjëse për zhvillim rajonal planifikon buxhetin për financim për zbatimin e PZHRB-së përmes buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës, përmes Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, në linjë me prioritetet dhe objektivat strategjike për zhvillimin rajonal të balancuar.

4. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar krijohet si nën-program buxhetor i veçantë në kuadër të buxhetit të Ministrisë.
5. Shpërndarja e buxhetit bëhet sipas masave dhe kategorive ekonomike të përcaktuara me PZHRB.
6. Minimumi i bashkëfinancimit të vlerës totale të projekteve nga ana e përfituesve apo organizatave donatore do të përcaktohet me PZHRB sipas masave të financimit.
7. Financimi i çdo projekti do të bëhet sipas shumave minimale dhe maksimale që përcaktohen me kriteret e udhëzuesve për aplikim.
8. Udhëzuesit për aplikim do të specifikojnë kushtet sipas Thirrjes për propozime, shumat, përqindjet minimale dhe maksimale të kostove, si dhe trajtimi i kontributeve në natyrë.

Neni 19

Metodologjia e ndarjes së mbështetjes financiare për rajonet zhvillimore

1. Mbështetja financiare për rajonet zhvillimore të PZHRB bëhet sipas formulës në të cilën përfshihen komponentat e nenit 5 të ligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar.
2. Ministria nxjerr vendim të veçant për indikatorët e zhvillimit bazuar në të dhënat e përdituara nga institucionet përkatëse.

KAPITULLI IV

PROCEDURAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR

Neni 20

Procedurat e përgjithshme për zbatimin e PZHRB-së

1. Procedura e ndarjes së mbështetjes financiare nga MZHR do të zhvillohet mbi bazën e thirrjeve publike dhe thirrjes specifike për Planet Operacionale.
2. Buxheti i paraparë për mbështetje financiare, fushat e mbështetjes financiare, dokumentet e nevojshme për aplikim, udhëzimet për aplikim dhe informata tjera me rëndësi publikohen përmes thirrjes publike.
3. Thirrja publike për secilën mbështetje financiare duhet të publikohet në ueb faqen e ministrisë përgjegjëse për zhvillim rajonal. Thirrja publike mund të publikohet edhe përmes mjeteve tjera.
4. Në thirrjen publike përcaktohen saktë kriteret e veçanta për pjesëmarrje, mënyra e aplikimit dhe procedurat që duhen zbatuar gjatë aplikimit për mbështetje financiare.

Neni 21 **Obligimet e palëve**

Të drejtat dhe përgjegjësit e palëve si dhe kushtet dhe kriteret për menaxhimin e projekteve nga PZHRB përcaktohen nga Ministria me Kontratë/Marrëveshje, të cilat nënshkruhen ndërmjet palëve.

Neni 22 **Kriteret e vlerësimit të projekt propozimeve**

1. Kriteret e vlerësimit të projekteve që do të specifikohen me materialet e thirrjes publike për aplikim dhe fushat kryesore të kriterëve të vlerësimit janë:

- 1.1. Kapaciteti financiar dhe operacional;
- 1.2. Relevanca e veprimit;
- 1.3. Efektshmëria dhe arritshmëria;
- 1.4. Qëndrueshmëria e projektit;
- 1.5. Buxheti dhe efektshmëria në kosto,

2. Për t'u paraselektuar, projekti duhet të përmbushë kriterin bazik – të jetë i kompletuar administrativisht dhe të arrijë një vlerësim nga Komisioni vlerësues së paku 50% të pikëve.

3. Pas vlerësimit, aplikacionet renditen sipas pikëve të tyre. Aplikimet me pikët më të larta do të zgjidhen përkohësisht deri në masën e buxhetit në dispozicion për atë masë.

KAPITULLI V **PROCEDURAT E APLIKIMIT**

Neni 23 **Thirrja për Aplikim**

1. Të gjitha proceset përgatitore: hartimin dhe konsultimin e përmbajtjes së Programit dhe Draft – Thirrjes për aplikim, Ministria mund ta realizojë gjatë vitit, për vitin vijues.

2. Thirrjen për Aplikim dhe udhëzuesit për aplikues i publikon Ministria, pas miratimit të buxhetit vjetor.

Neni 24 **Dorëzimi i aplikacioneve**

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve përcaktohet me thirrjen publike për aplikim, të publikuar nga Ministria.

Neni 25
Procedura e shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve

1. Gjatë procesit të thirrjes publike për aplikim, Ministria ndërmerr hapat si në vijim:

1.1. Procedurat për shqyrtimin e aplikacioneve janë:

1.1.1. Dorëzimi i aplikacionit nga aplikuesi në adresën e përcaktuar në thirrjen publike;

1.1.2. Shqyrtimi administrativ i aplikacioneve;

1.1.3. Procesi i vlerësimit të aplikacioneve;

1.1.4. Kontrolli i parë në terren;

1.1.5. Miratimi i projekteve;

1.1.6. Njoftimi i aplikuesit me rezultatin e vlerësimit të projektit;

1.1.7. Periudha e ankimit/E drejta e ankesës;

1.1.8. Nënshkrimi i kontratës ndërmjet përfituesit dhe Ministrisë (në Kontratë/Marrëveshje specifikohe elementet e detajuara);

1.1.9. Zbatimi i procedurave administrative bëhet sipas Legjislacionit në fuqi (Ligji përkatës për Procedurat Administrative);

2. Pas pranimit të aplikimeve, për secilën thirrje publike Ministria me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm formon Komisionin për shqyrtimin administrativ dhe vlerësimin e aplikimeve/projekteve. Në Komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve duhet të përfshihen edhe përfaqësues të jashtëm. Përbërja e Komisionit Vlerësues përcaktohet me akt të brendshëm të ministrisë sipas rregullave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

3. Komisioni vlerësues zhvillon metodologjinë dhe mjetet për vlerësimin e projekteve.

4. Shqyrtimi administrativ kompletohet në pajtim me Legjislacionin në fuqi, dhe sipas udhëzuesit për vlerësim.

5. Projektet, të cilat nuk e kalojnë procesin administrativ të shqyrtimit, të njëjtat nuk procedohen për shqyrtim përmbajtësor.

6. Vlerësimi dhe poentimi i aplikimeve të pranueshme duhet të kryhet brenda 45 ditëve kalendarike, përveç në rastet kur Komisioni vlerësues merr miratim nga Sekretari i Përgjithshëm për shtyrje të afatit.

7. Sipas vlerësimit dhe poentimit të projekteve, bëhet shpallja publike e Listës preliminare të përfitueseve të mundshëm të projekteve të zhvillimit rajonal të balancuar. Njoftimi për publikimin e Listës bëhet përmes komunikimit publik.

8. Lista me përfituesit e mundshëm/projektet e përzgjedhura dërgohet te Divizioni për Zhvillim dhe Menaxhim të Projekteve në Departamentin për Zhvillim Rajonal në Ministri për kontrollin e parë në terren, i cili duhet të fillojë menjëherë.

9. Në bazë të vizitave verifikuese në terren hartohet Raporti përmes të cilit bëhet miratimi i projekteve të zhvillimit rajonal të balancuar për financim dhe aprovet Lista përfundimtare.

10. Të gjithë aplikuesit informohen për përzgjedhjen ose refuzimin e projektit të tyre përmes nr. të protokollit, i cili publikohet në ueb-faqen e Ministrisë (nr. Me të cilin aplikuesit njoftohen gjatë fazës së vlerësimit administrativ).

11. Për vlerësimin e projekteve, Komisioni vlerësues i Ministrisë përdor Listën Kontrolluese për Kriteret e pranueshmërisë dhe poentimin.

12. Nënshkrimi i Kontratës / Marrëveshjes ndërmjet përfituesit dhe Ministrisë bëhet pas miratimit të Raportit / hartimit të Listës përfundimtare të përfitueseve të projekteve të zhvillimit rajonal të balancuar dhe njoftimit të aplikuesve përfitues.

13. Pas nënshkrimit të Kontratës/Marrëveshjes, përfituesi është i obliguar që të fillojë zbatimin e projektit sipas kontratës.

Neni 26

Afati i zbatimit të projekteve

1. Afati i zbatimit të projekteve është deri në 1 vit, përveç kur përcaktohet ndryshe me Kontratë/Marrëveshje të nënshkruar nga përfituesi dhe ministri i Ministrisë, apo të autorizuarit.

2. Pas afatit të zbatimit, përfituesit kanë një afat shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesën e fundit, si dhe hartimin e raportit final.

3. Ministria mund të zgjasë afatin e zbatimit, në rast se ka kërkesë të arsyeshme dhe të qëndrueshme për këtë, siç mund të jenë ekzekutimi i punëve specifike, apo edhe sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër.

Neni 27

Kushtet e pagesës dhe dokumentacioni i kërkuar për pagesë

1. Realizimi i pagesës për përfituesin/it bëhet sipas kushteve, obligimeve dhe detyrimeve të cilat janë përcaktuar në Kontratën/Marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet palëve.

2. Për realizimin e pagesës përfituesit duhet të dorëzojnë dokumentet e kërkuara sipas legjislacionit

në fuqi, udhëzuesit për zbatimin e projekteve të hartuar nga Ministria dhe dokumentet e tjera sipas specifikës së projektit.

Neni 28 Ankimimi

1. Afati i ankimimit fillon në ditën e publikimit të përfitueseve të mundshëm të projekteve, si dhe zgjat konform thirrjes publike për aplikim.

2. Ministria, me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm, pas çdo thirrje për aplikim, apo pas publikimit të rezultateve definitive e formon Komisionin e ankesave, në përbërje prej tre (3) anëtareve, të cilët nuk duhet të jenë pjesë e vlerësimit të asnjërës fazë.

3. Në vendimin për formimin e Komisionit të ankesave përcaktohen saktë detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit.

KAPITULLI VI MONITORIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT

Neni 29 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i zbatimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

1. Ministria, përkatësisht Departamenti përkatës për Zhvillim Rajonal, është përgjegjës për menaxhimin e procesit të monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të PZHRB-së.

2. Ministria përgjegjëse për zhvillim rajonal do të hartojë raporte periodike gjashtë mujore dhe vjetore për zbatimin e PZHRB-së.

3. Vlerësimi i arritjes së objektivave të programit do të bëhet pas periudhës trevjeçare.

4. Monitorimi, raportimi i zbatimit të PZHRB dhe vlerësimit të arritjes së objektivave të tij do të bëhet sipas rregullave dhe metodologjisë për monitorim, raportim dhe vlerësim të dokumenteve të politikave publike të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe udhëzuesit përkatës për këto dokumente.

5. Për menaxhimin dhe koordinimin e procesit të monitorimit, raportimit, vlerësimit dhe të zbatimit të PZHRB Ministria mund të themelojë strukturat të veçanta të niveleve dhe standardeve të larta.

Neni 30

Monitorimi dhe vlerësimi në nivel të projekteve të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

1. Ministria, përkatësisht Departamenti përkatës për Zhvillim Rajonal, është përgjegjës për menaxhimin vlerësimin dhe monitorimin e projekteve, si dhe për gjithë procesin.
2. Ministria do të emërojë zyrtarin përgjegjës apo të themelojë ekip të veçantë për secilën kontratë të lidhur me përfitues, me qëllim të monitorimit të zbatimit të projektit/programit si dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivave dhe arritjes së rezultateve të parapara.
3. Për monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të projekteve, varësisht nga specifikat e projekteve Ministria mund të angazhojë kontraktues të jashtëm (persona juridikë ose fizikë) që ofrojnë ekspertizë në fushat përkatëse. Kontraktimi i kontraktuesve të jashtëm do të bëhet sipas rregullave dhe procedurave përkatëse.
4. Ministria, përmes udhëzuesve të saj të brendshëm, mund të vendosë afate, forma apo metoda tjera për monitorim.

KAPITULLI VII
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR MENAXHIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR

Neni 31
Ministria e Zhvillimit Rajonal

1. Ministria ka përgjegjësitë si në vijim:
 - 1.1. Udhëheq përgatitjen dhe rishikimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe ia propozon Qeverisë për miratim.
 - 1.2. Është autoritet menaxhues për programin e zhvillimit rajonal të balancuar të Ministrisë.
 - 1.3. Përgatitë raporte periodike për implementimin, monitorimin dhe menaxhimin e Programit për zhvillim rajonal të balancuar.
 - 1.4. Përgatitë raporte periodike për implementimin, monitorimin dhe menaxhimin e projekteve të zhvillimit rajonal të balancuar;
 - 1.5. Krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave të projekteve të financuara nga Programi për Zhvillim Rajonal të balancuar dhe harton raporte periodike;

1.6. Mbështet komunat në zhvillimin e kapaciteteve për përgatitjen e projekteve që mbështeten nga PZHRB, menaxhimin e tyre në kuadër të rajoneve zhvillimore dhe akterët e tjerë të zhvillimit;

1.7. Në pajtim me Ligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar vendos për përfituesit të projekteve të zhvillimit rajonal sipas Programit për Zhvillim Rajonal të balancuar.

Neni 32 Komunat

1. Ofrojnë bashkëpunimin e nevojshëm për përgatitjen, monitorimin dhe raportimin e PZHRB-së.
2. Bashkëpunojnë me Qendrat për zhvillim rajonal për të mundësuar zbatimin e PZHRB-së në rajonet të cilat ju përkasin.
3. Në pajtim me PZHRB-së përgatisin projekt propozime për zhvillim rajonal të balancuar për rajonin të cilit i përkasin.
4. Ofrojnë të dhënat e kërkuar nga Ministria përgjegjëse për zhvillim rajonal për llogaritjen e treguesve të përcaktuar për matjen e indeksit për zhvillim rajonal të balancuar.
5. Sigurojnë bashkëfinancimin e nevojshëm për projektet për të cilat aplikojnë në kuadër të PZHRB.
6. Angazhohen me institucionet tjera dhe partnerët tjerë për sigurimin e bashkëpunimit në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të projekteve të PZHRB-së.

Neni 33 Qendrat për Zhvillim Rajonal

Mbështesin Ministrinë përgjegjëse për Zhvillim Rajonal në procesin e hartimit të programit për zhvillim rajonal të balancuar në përputhje me nenin 8 të Ligjit Nr.08/L-190 për zhvillim rajonal të balancuar.

KAPITULLI VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 34 Raportimi

1. Secili përfitues që ka Kontratë/Marrëveshje me Ministrinë ka për obligim të raportojë ashtu siç përcaktohet me Kontratë/Marrëveshje.

2. Ministria, çdo vit, më së largu deri më 31 mars, raporton në Zyrën e Kryeministrit lidhur me realizimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, për vitin paraparak.

Neni 35 Zbatimi

1. Për zbatimin e Rregullores për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Ministria do të përgatisë udhëzues për secilën thirrje veç e veç.

2. Rregullat aktuale të mbështetjes për projektet të cilat janë në procedurë do të zbatohen deri në miratimin e Programit dhe planeve operationale për zhvillim rajonal të balancuar, si dhe hyrjes në fuqi të rregullores për qendrat e zhvillimit rajonal.

Neni 36 Shfuqizimi

Kjo Rregullore shfuqizon Udhëzimin Administrativ (MZHR) NR. 01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e UA (MZHR) NR. 01/2018 i ndryshuar dhe plotësuar me UA Nr. 02/2018 për kushtet dhe kriteret e përkrahjes së bizneseve/ndërmarrësve të rinj nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

Neni 37 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

30 gusht 2024